



VENDIM

Nr.81 Datë 04.11.2009

**PËR
SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE
VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË ALB WIND ENERGY
SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.11.2009, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorise se Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë ALB WIND ENERGY sh.p.k

Dhe duke konsideruar :

Kompleksitetin e problematikes që i licensuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qënë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolik përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencen teknike të huaj,

Për gjithë sa më sipër,

Vendosi:

1. Të shtyje me 12 muaj duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi afatet për realizimin e kushteve të shprehura në pikat 1 dhe 4 të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr.13, dt.28.01.2008 “Për dhënien e licenses për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrik me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike”, ndryshuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.143, dt.29.12.2008.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.